

ÇMIMI PËR PARTNERËT E TË RINJVE THIRRJE PËR NIMINIME PËR NËPUNËS PËR TË RINJTË

I. RRETH ÇMIMIT

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë (MSPDR) dhe Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë (KRNM) ,në partneritet me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), këtë vit, për herë të parë, ndajnë Çmimin për Partnerët e të Rinjve.

Çmimi synon të njohë, të vlerësojë dhe të promovojë përkushtimin e nëpunësve për të rinjtë, të cilët përmes punës, angazhimit dhe përkushtimit të tyre kontribuojnë në përmirësimin e politikave rinore, mbështetjen e iniciativave rinore dhe vendosjen e një komunikimi funksional ndërmjet të rinjve dhe institucioneve.

Nëpunësit për të rinjtë kanë një rol kyç në afrimin e institucioneve me të rinjtë, sigurimin e informacionit dhe mbështetjes, si dhe në krijimin e mundësive që të rinjtë të marrin pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin lokal dhe në proceset shoqërore.

Përmes këtij çmimi, vlerësohen ata nëpunës të cilët tejkalojnë rolin formal të pozitës së tyre dhe janë partnerë të vërtetë të të rinjve.

II. KUSHTET PËR NOMINIM

Për Çmimin për Partnerët e të Rinjve – kategoria Nëpunës për të Rinj, mund të nominohet një person i cili i plotëson kushtet e mëposhtme:

- Të jetë i emëruar si nëpunës për të rinjtë në kuadër të një institucioni/njësie të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me dispozitat në fuqi, së paku gjashtë muaj para ditës së publikimit të kësaj thirrjeje;
- Të ketë angazhim aktiv në lidhje me punën me të rinjtë;
- Të kontribuojë në përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit midis të rinjve dhe institucioneve;
- Të ketë aktivitete, iniciativa ose procese të zbatuara që kanë ndikim pozitiv tek të rinjtë;
- Të tregojë përkushtim ndaj parimeve të pjesëmarrjes rinore, mundësive të barabarta dhe gjithëpërfshirjes.

Nominimi mund të paraqitet:

- personalisht;
- forma të organizimit rinor;
- grupet joformale të të rinjve;
- institucionet;
- aktorë të tjerë relevantë ose individë që kanë përvojë të drejtpërdrejtë me punën e nëpunësit të nominuar për të rinjtë.

III. KRITERET E NOMINIMIT

Gjatë paraqitjes së propozimit, është e nevojshme të merren parasysh kriteret e mëposhtme:

- kandidati tregon përkushtim aktiv në mbështetjen e të rinjve, nevojave dhe iniciativave të tyre.
- kandidati kontribuon në rritjen e mundësive që të rinjtë të jenë të informuar, të konsultohen dhe të përfshihen në proceset e marrjes së vendimeve.
- kandidati kontribuon në mënyrë aktive në zbatimin e aktiviteteve, masave ose mekanizmave që përmirësojnë statusin dhe mundësitë për të rinjtë.
- kandidati krijon dhe promovon bashkëpunimin me organizatat rinore, organizatat për të rinjtë, grupet rinore joformale dhe aktorë të tjerë relevantë.
- kandidati demonstroi iniciativë, zhvillon qasje të reja dhe kontribuon në përmirësimin e shërbimeve dhe mundësive në dispozicion të të rinjve.
- puna e kandidatit ka rezultate të dukshme dhe të matshme dhe një ndikim pozitiv taktërinjtë dhe komuniteti.

IV. ÇMIMI

Çmimi për Partnerët e të Rinjve synon të njohë, të nxjerrë në pah dhe të vlerësojë kontributin e kandidatëve të nominuar, të cilët përmes punës dhe angazhimit të tyre krijojnë ndryshime pozitive për të rinjtë dhe kontribuojnë në avancimin e pjesëmarrjes rinore dhe partneritetit me të rinjtë.

Çmimi përbëhet nga mbështetje financiare për avancim profesional ose akademik në fushën e punës me të rinjtë dhe/ose pajisje teknike për nëpunësin për të rinjtë, si dhe mbështetje në natyrë për realizimin e një iniciative lokale për të rinjtë.

V. UDHËZIME PËR PARAQITJEN E NOMINIMIT

Nominimet dorëzohen duke plotësuar formularin në linkun e mëposhtëm:

➤ [NOMINIM PËR NËPUNËS PËR TË RINJ](#)

Bashkë me nominimin mund të bashkëngjiten letra mbështetëse ose rekomanduese me përshkrim narrativ të kontributit dhe punës së nëpunësit të nominuar për të rinjtë, si dhe raporte, dokumente dhe dëshmi të tjera për punën e nëpunësit për të rinjtë.

Afati i fundit për dorëzimin e nominimeve është data 29 korrik 2026, ora 23:59.

VI. KRITERET DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT

Pas përfundimit të procesit të dorëzimit të nominimeve, të gjitha aplikimet do të shqyrtohen sipas kriterëve teknike, me qëllim përcaktimin nëse i plotësojnë kushtet bazë për shqyrtim të mëtejshëm.

Nominimet e paraqitura do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga një komision i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dhe Këshillit Rinor Nacional të Maqedonisë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Vlerësimi do të kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:

- Relevanca dhe cilësia e arsytimit të nominimit;
- Shkalla e kontributit në përmirësimin e pozitës dhe mundësive për të rinjtë;
- Dëshmi për rezultate konkrete dhe ndikim;
- Niveli i bashkëpunimit me të rinjtë dhe aktorët rinorë;
- Inovacioni dhe qëndrueshmëria e qasjes.

Nëse është e nevojshme, Komisioni mund të kërkojë informacione ose sqarime të mëtejshme.

Vendimi për fituesin e çmimit do të merret në bazë të vlerësimit të përgjithshëm të nominimit dhe kontributit të kandidatit në ndërtimin e partneritetit me të rinjtë.

Rezultatet do të shpallen si pjesë e ngjarjes zyrtare më 12 gusht 2026 me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Rinisë.

Komisioni do t'i vlerësojë nominimet sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht, të ndara në katër kategori:

Kategoria	Kriteri	Numri maksimal i pikëve
1. Përkushtim dhe angazhim për të rinjtë (maksimumi 30 pikë)	Përkushtim i demonstruar për të punuar me të rinjtë dhe për të kuptuar nevojat dhe sfidat me të cilat përballen të rinjtë	10
	Qasshmëri, mbështetje dhe ndërmjetësim aktiv ndërmjet të rinjve dhe institucioneve	10
	Aktivitete dhe iniciativa të ndërmarra jashtë përgjegjësisë kryesore të punës me qëllim mbështetjen e të rinjve	10
2. Kontribut në pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore (maksimumi 30 pikë)	Kontribut në përfshirjen e të rinjve në proceset e konsultimit, vendimmarrjes dhe politikëbërjes	10
	Mbështetja e iniciativave rinore, organizatave rinore dhe grupeve joformale rinore	10
	Kontribut në përmirësimin e shërbimeve, mekanizmave dhe mundësive në dispozicion të të rinjve	10
3. Bashkëpunim dhe ndërtimi i partneriteteve (maksimumi 20 pikë)	Bashkëpunimi me organizatat rinore, institucionet dhe aktorë të tjerë relevantë	15
	Krijimi i besimit dhe komunikimit pozitiv me të rinjtë dhe komunitetin rinor	5
4. Inovacioni dhe ndikimi (maksimumi 20 pikë)	Qasje inovative, ide të reja dhe përmirësim të mënyrës së punës me të rinjtë	10
	Rezultatet e dukshme, ndikimi dhe qëndrueshmëria e aktiviteteve të ndërmarra	10
Gjithsej pikë		100

VII. KORNIZA KOHORE

THIRRJE PËR NOMINIME	15 KORRIK 2026
AFATI I FUNDIT PËR DORËZIMIN E NOMINIMEVE	29 KORRIK 2026
SHQYRTIMI I NOMINIMEVE DHE PËRZGJEDHJA	29-31 KORRIK 2026
NJOFTIMI I FITUESVE	5-10 GUSHT 2026
NGJARJA PËR NDARJEN E ÇMIMEVE	12 GUSHT 2026

* Datat e mësipërme janë subjekt ndryshimi